

**V E N D I M**  
**Nr.584, datë 28.8.2003**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, 22 pikat 2, 23 pika 2, 24 pikat 4 dhe 25 pika 4 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rregullore së Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr.81, datë 6.2.1995 i Këshillit të Ministrave "Për rregullat e funksionimit të Këshillit të Ministrave", shfuqizohet.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**RREGULLORE**  
**E KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me:
  - a) përgatitjen dhe paraqitjen e projektakteve, si dhe shqyrtimin e tyre në Këshillin e Ministrave;
  - b) organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave.
2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
  - a) "Ministri propozues" është ministri që ka filluar procedurat për hartimin e projektaktit dhe pasi ka marrë vlerësimet paraprake, e propozon projektaktin për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave.
  - b) "Nismë propozuese" është ushtrimi i së drejtës ligjore për të hartuar dhe propozuar për shqyrtim e miratim projektakte.
  - c) "Projektakti" është projekti i një ligji, akti me fuqinë e ligjit, sipas nenit 101 të Kushtetutës, vendimi ose udhëzimi që paraqitet për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.
  - ç) "Programi analitik i projektakteve" është lista e projektakteve që parashikohen të hartohen dhe të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, sipas programit të ministrive.

**KREU II**  
**NISMA PËR PROJEKTAKTIN**

3. Kryeministri dhe çdo ministër kanë të drejtën e propozimit të projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.
4. Ministrat e ushtrojnë këtë të drejtë në përputhje me fushat e veprimtarisë shtetërore që kanë në kompetencë, si dhe me përgjegjësitë që burojnë nga strategjitë dhe dokumentet e tjera të miratuara për drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Kryeministri e ushtron këtë të drejtë në çdo rast, kryesisht ose kur kjo e drejtë nuk është ushtruar nga ministri përkatës.
5. Projektaktet që përmbajnë normimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave nga Kryeministri. Sipas vlerësimit të tij, bashkëpropozues të projektaktit mund të jenë edhe një ose disa ministra të tjerë.
6. Kur fusha e marrëdhënieve që rregullon projektakti lidhet me veprimtari, të cilat janë në

kompetencë të më shumë se një ministri, nisma për propozimin e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, ushtrohet bashkërisht nga ministrat përkatës.

7. Si rregull, brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik dhe në çdo rast, brenda afatit të caktuar nga Kryeministri, sipas fushës së veprimtarisë që kanë në kompetencë, ministrat i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave projektprogramin e hollësishëm të projektakteve që parashikojnë të propozojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në vitin pasardhës.

8. Projektprogrami i detajuar i projektakteve për çdo fushë veprimtarie duhet të jetë i ndarë në katërmujorë dhe të përmbajë:

a) listën e projektakteve që parashikohen të propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave,

b) afatin e paraqitjes së tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, me qëllim shqyrtimin në mbledhjen e Këshillit të Ministrave;

c) relacion të hollësishëm me shpjegimet e nevojshme lidhur me arsyet kryesore për propozimin e projektaktit, çështjet më të rëndësishme që parashikohen të rregullohen prej tij, përputhshmërinë me programin politik të Këshillit të Ministrave, me programet kombëtare ose sektorale të zhvillimit të vendit.

9. Kryeministri bashkërendon procesin e përgatitjes së programit analitik të projektakteve dhe e propozon për miratim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

10. Pas miratimit të programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, sipas fushës së veprimtarisë që ka në kompetencë, ministri urdhëron miratimin e programit të hollësishëm të masave, afateve dhe strukturave përgjegjëse për zhvillimin e procesit legjislativ në tërësi dhe për çdo projektakt, raportimin për ecurinë e tyre deri në përfundimin e hartimit të projektaktit dhe paraqitjen e tij për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

11. Ministri propozues ua dërgon projektaktin për mendim ministrive dhe institucioneve të interesuara, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së përcaktuar në programin analitik të miratuar.

### KREU III PËRGATITJA E PROJEKTAKTIT

12. Përpara fillimit të procesit të hartimit të projektaktit, strukturat teknike në bashkërendim me strukturën juridike, bëjnë vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektaktit ku përfshihen, ndërmjet të tjerave, shpjegime lidhur me:

a) qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen;

b) përputhshmërinë me programin politik dhe me programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, si dhe me strategjitë e programet e miratuara mbi drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore;

c) pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi;

ç) parashikimet dhe masat, që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e projektaktit;

d) shpenzimet buxhetore dhe efektet financiare të pritshme.

13. Mbështetur në vlerësimin paraprak të projektaktit, ministri cakton me urdhër të veçantë çështjet që duhen rregulluar, format e pjesëmarrjes dhe hapat kryesore të realizimit dhe bashkërendimit të procesit legjislativ, afatet përkatëse për realizimin e tyre, strukturat përgjegjëse, si dhe burimet njerëzore dhe materiale që ngarkohen të bashkëpunojnë me strukturën juridike për hartimin e çdo projektakti.

14. Projektaktet hartohen nën përgjegjësinë e strukturës juridike, e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të ministrisë, organizon këshillime me drejtues a specialistë të drejtorive, sektorëve a enteve, si dhe me struktura të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave lidhet me objektin, qëllimin dhe zbatimin e projektaktit.

15. Për përgatitjen e projektakteve, struktura juridike mund të kërkojë mendimin e ekspertëve të tjerë, brenda ose jashtë ministrisë.

16. Në bashkërendim me strukturën juridike, strukturat përgjegjëse përpilojnë relacionin shpjegues të projektaktit, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare, si dhe plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm shoqërues përpara se t'i dërgohen

për shqyrtim ministrit.

17. Në përfundim të konsultimeve dhe shqyrtimit të projektaktit, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit ekonomik dhe dokumentacionit shoqërues, ministri pasi vlerëson nismën, vendos dërgimin e tyre për mendim në ministritë dhe institucionet e interesuara ose urdhëron rishikimin e tyre brenda një afati të caktuar prej tij.

18. Projektakti i dërguar për mendim duhet të shoqërohet me relacionin shpjegues dhe me raportin e vlerësimit të shpenzimeve buxhetore për zbatimin e tij.

19. Relacioni shpjegues duhet të përmbajë:

a) Qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen.

b) Vlerësimin politik dhe lidhjen ose jo të projektaktit me programin politik të Këshillit të Ministrave, aktet që kanë miratuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, si dhe dokumente të tjera për strategjitë dhe politikat e zhvillimit.

c) Argumentimin e propozimit të projektaktit, duke bërë analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projektaktit, nivelin e efektivitetit, zbatueshmërisë, efikasitetit, impaktit dhe efekteve përkatëse, si dhe kostos ekonomike që rezultojnë në raport me legjislativën në fuqi.

ç) Vlerësimin paraprak të ligjshmërisë dhe përputhshmërisë së formës dhe përmbajtjes së projektaktit me Kushtetutën, harmonizimin e tij me legjislativën në fuqi dhe me normat e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

d) Vlerësimin eventual për projektaktet normative, të shkallës së përafritimit të përmbajtjes së tyre me legjislativën komunitar (acquis communautaire).

dh) Përmbledhje shpjeguese të përmbajtjes së projektaktit.

e) Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e aktit.

ë) Personat dhe institucionet që kanë kontribuar në hartimin e projektit.

20. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore duhet të përmbajë:

a) shumën e përgjithshme të shpenzimeve vjetore për zbatimin e aktit;

b) parashikimet e hollësishme për çdo zë të buxhetit, të nevojshme për zbatimin e aktit;

c) kohën e fillimit të efekteve financiare;

ç) shpenzimet e detajuara për strukturat që ngarkohen me zbatimin e aktit;

d) burimet e sigurta dhe të pritshme të financimit;

dh) analizën e rritjes apo të pakësimit të shpenzimeve buxhetore, të paktën për tre vitet e para të zbatimit të tij;

e) vlerën e detyrimeve fiskale të pritshme apo të përjashtuara, që parashikon projektakti;

ë) kur projektakti ka për objekt miratimin e përdorimit apo të shpërndarjes së fondeve publike, shoqërohet me preventivin përkatës.

21. Për projektaktet që kanë objekt miratimin ose ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, plotësimi i të dhënave sipas pikave 19 dhe 20 të kësaj rregulloreje, të përgatiten përpara miratimit të tyre në parim.

#### KREU IV

#### DHËNIA E MENDIMEVE PËR PROJEKTAKTIN

22. Të gjitha projektaktet pa përjashtim i dërgohen për mendim Ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes, për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative dhe për terminologjinë juridike të projektaktit duke parashtruar, kur është rasti, edhe formulimet përkatëse.

23. Nëse projektakti shoqërohet me efekte financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, në çdo rast i dërgohet për mendim Ministrit të Financave dhe sipas rastit, Ministrit të Ekonomisë.

24. Nëse projektakti përmban çështje që lidhen me disponimin dhe administrimin e pronave publike dhe shtetërore, me financime të huaja dhe marrëdhënie ekonomike me jashtë, si dhe me impakte në ecurinë e zhvillimit të ekonomisë, në çdo rast i dërgohen për mendim Ministrit të

Ekonomisë dhe sipas rastit, Ministrinë të Financave.

25. Projektaktet me karakter normativ i dërgohen për mendim Ministrinë të Shtetit për Integrimin, që jep vlerësimin e tij lidhur me nevojën ose shkallën e përafrimit të tij me legjislacionin komunitar (acquis communautaire), përshtatshmërinë me legjislacionin ndërkombëtar, si dhe pajtueshmërinë me angazhimet kundrejt strukturave ndërkombëtare.

26. Të gjitha projektaktet me objekt miratimin në parim të marrëveshjeve ndërkombëtare i dërgohen për mendim Ministrinë të Punëve të Jashtme.

27. Projektaktet me përmbajtje shoqërore, me efekte në burime njerëzore, i dërgohen për mendim Ministrinë të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Departamentit të Administratës Publike.

## KREU V BASHKËRENDIMI I PROJEKTAKTEVE

28. Ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara ia dërgojnë mendimin e tyre për projektaktin, ministrit propozues në formë shkresore, jo më vonë se 7 ditë-pune nga data e marrjes së tij. Për Ministrinë e Drejtësisë, në rastin e projektligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe akteve nënligjore voluminoze ky afat është 10 ditë-pune.

29. Mendimet e ministrave dhe institucioneve të interesuara përmbajnë vërejtje, komente ose sugjerime për çështje teknike të formës dhe përmbajtjes së projektaktit, relacionit shpjegues, raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe dokumentacionit tjetër shoqëruar duke u përqëndruar, si rregull, në dhënien e mendimit të specializuar sipas fushave përkatëse të veprimtarisë që kanë në kompetencë.

30. Projektakti ripunohet duke marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e ministrave dhe të titullarëve të institucioneve të tjera të interesuara. Vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga Ministri i Drejtësisë dhe sipas rastit ministrat e treguar në pikat 23 deri 27 të kësaj rregulloreje, shihen me përparësi gjatë ripunimit të projektaktit.

31. Mendimi juridik i Ministrinë të Drejtësisë, lidhur me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së projektaktit, reflektohet në ripunimin e projektaktit nga ministri propozues, duke zhvilluar për këtë qëllim, nëse çmohet e nevojshme, konsultime të përbashkëta ose ridërguar atë për mendim përfundimtar.

32. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri duhet të paraqesë për çdo çështje edhe argumentet përkatëse dhe kur është rasti, riformulimet e nevojshme të dispozitave të projektaktit.

33. Kur nga përmbajtja e mendimeve të dërguara nga ministrat dhe titullarët e institucioneve të interesuara, rezulton se ato sugjerojnë zgjidhje të tjera alternative ose që kundërshtojnë pjesërisht a tërësisht thelbin e përmbajtjes së projektaktit, ministri propozues mund të vendosë:

- a) tërheqjen e plotë ose të pjesshme të propozimit të projektaktit;
- b) rishikimin e përmbajtjes së tij edhe me anë të konsultimeve me ministrat përkatës;
- c) kur çmon se nga procesi i konsultimeve sipas shkronjës "b" të kësaj pike nuk zgjidhen kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet ose zgjidhjet alternative të sugjeruara ose kundërshtimet janë të paargumentuara, i dërgon menjëherë Kryeministrit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, kërkesën e motivuar për bashkërendimin e qëndrimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tij dhe ministrave përkatës, së bashku me projektaktin dhe dokumentacionin sipas pikës 45 të kreut VI të kësaj rregulloreje.

34. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave kur vëren se projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron nuk përmbush kriteret e pikës 47, shkronjat "a" dhe "b" të kreut VI të kësaj rregulloreje, vendos kthimin e motivuar të projektaktit ministrit propozues.

35. Kur projektakti dhe dokumentacioni që e shoqëron është i plotë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos dërgimin e tij për shqyrtim nga Kryeministri, duke i bashkëlidhur një relacion shpjegues teknik për përmbajtjen, problematikën dhe zgjidhje të mundshme të sugjeruara lidhur me kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet e evidentuara.

36. Kryeministri vendos sipas rrethanave:

- a) thirrjen në konsultë të ministrave të interesuar dhe personave të tjerë që çmohen prej tij, përpara se të marrë vendimin përkatës;

b) delegimin e zgjidhjes së çështjeve Zëvendëskryeministrit ose Ministrit të Shtetit të ngarkuar me koordinimin qeveritar ose Sekretarit të Përgjithshëm, kur thelbi i kundërshtive lidhet vetëm me çështje të ligjshmërisë. Së bashku me delegimin, Kryeministri cakton edhe modalitete dhe afatet përkatëse të kësaj procedure dhe për raportin e rezultateve që duhet t'i paraqiten për miratim ose vendimmarrje;

c) dërgimin e projektaktit për shqyrtim dhe konsultim më të gjerë në komitetet ndërministrorë.

37. Në rastin e shkronjes "a" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, ministri propozues dhe ministrat e titullarët e tjerë të institucioneve të interesuara marrin masa për zbatimin e vendimit të Kryeministrit në mënyrën dhe afatin e caktuar prej tij.

38. Në rastin e shkronjës "b" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, autoriteti i deleguar organizon konsultimin me pjesëmarrjen e ministrave të interesuar dhe funksionarëve të tjerë politikë dhe sipas rastit, të departamentit juridik dhe atij të koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave, të strukturave juridike dhe teknike të ministrave të interesuara dhe personave të tjerë që mund të japin kontribut në zgjidhjen e çështjes. Në përfundim të konsultimit, autoriteti i deleguar i raporton me shkrim Kryeministrit duke propozuar për miratim ose vendimmarrje zgjidhjet eventuale të çështjes.

39. Në rastin e shkronjës "c" të pikës 36 të kësaj rregulloreje, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masat për përfshirjen e çështjes në rendin e ditës dhe organizimin e mbledhjes së Komitetit Ndërmintor, sipas modaliteteve dhe afateve të caktuara nga Kryeministri.

40. Nëse është e nevojshme, sipas urdhërimeve të Kryeministrit, Sekretari i Përgjithshëm kujdeset për reflektimin teknik të zgjidhjeve të arritura, me pjesëmarrjen, sipas çmimit të tij të departamentit juridik dhe atij të koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave, të strukturave juridike dhe teknike të ministrave dhe institucioneve të interesuara ose ekspertëve të tjerë.

41. Në përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe për arsye të motivuara, për çështje dhe projektakte të një rëndësie të veçantë, Kryeministri nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë përfshirjen e tyre në rendin e ditës së mbledhjes së Komitetit Ndërmintor dhe shpërndarjen e materialeve të tij, pa kërkuar përmbushjen ose plotësimin e një apo më shumë elementeve të procedurave të bashkërendimit paraprak. Në këtë rast, ministri propozues, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, duhet t'u shpërndajë anëtarëve të komitetit kopje të projektit, të relacionit dhe të materialeve shoqëruese, në çastin që njoftohet data dhe rendi i ditës për mbledhjen e komitetit ndërministror.

42. Nëse projektakti miratohet në komitetin ndërministror, paraqitet për miratim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Ministrave. Kur për projektin nga Komiteti Ndërmintor janë bërë vërejtje, ministri propozues i reflekton ato dhe paraqet projektin e ripunuar, së bashku me materialet shoqëruese, për miratim në Këshillin e Ministrave.

## KREU VI

### PARAQITJA E PROJEKTAKTEVE PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE

43. Në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

44. Projektakti, relacioni shpjegues, dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të kësaj rregulloreje, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

45. Propozimet e projekteve shoqërohen me:

a) projektaktin e bashkërenduar me ministritë përkatëse;

b) relacionin shpjegues, i cili përveç të dhënave të parashikuara në pikat 19 dhe 20 të kreut të katërt të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë edhe shpjegime për arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve ose sugjerimeve të bëra nga ministritë e interesuara;

c) mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara. Në çdo rast mendimi i Ministrit të Drejtësisë duhet të shoqërojë projektaktin;

ç) tekstin e plotë të traktatit a marrëveshjeve ndërkombëtare, në gjuhë të huaj dhe në shqip, të

vërtetuar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, kur projektakti ka këtë objekt.

46. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kur vëren se dokumentacioni që shoqëron projektaktin është i plotë, e pranon atë për shqyrtim paraprak.

47. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave vendos kthimin e projektaktit ministrit propozues, vetëm kur:

a) mungon njëri nga dokumentet e përcaktuara në pikën 45 të këtij kreu të rregullores;

b) nuk është respektuar forma dhe përmbajtja e parashikuar në këtë rregullore për përgatitjen dhe hartimin e projektakteve, relacionit shpjegues dhe dokumenteve sipas pikave 19, 20 dhe vijuese të kësaj rregulloreje;

c) projektakti nuk është në pajtim me Kushtetutën, vjen në kundërshtim ose nuk është në harmoni me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e brendshëm;

ç) mangësitë e projektaktit, veçanërisht atyre me përmbajtje voluminoze, nga pikëpamja e teknikës legjislative, janë shumë të dukshme dhe të pranishme gjatë gjithë përmbajtjes së tij.

48. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave mund ta korrigjojë projektaktin në drejtim të teknikës legjislative dhe të terminologjisë së përdorur, por në asnjë rast nuk duhet të cenojë thelbin e tij.

49. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, për qartësimin e aspekteve teknike të përmbajtjes së projektaktit, thërret në konsultë strukturat juridike dhe teknike të ministrisë propozuese.

50. Për projektaktet me rëndësi të veçantë, Kryeministri i vënë në dijeni nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, shqyrton propozimin në bazë të disa kriterëve lidhur me urgjencën e propozimit, kërkesën e publikut, plotësimin e objektivave të politikave kombëtare të zhvillimit, mundësisë së zbatimit të shpejtë etj.

Këto projektakte mund të diskutohen në rrethe të gjera, ku mund të përfshihen përfaqësues të institucioneve shtetërore, OJF-ve, ekspertë të institucioneve ose organizatave ndërkombëtare etj.

51. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, kur vëren se ministrat ose drejtuesit e institucioneve të interesuara janë shprehur me shkrim kundër projektaktit, e dërgon projektin për bashkërendim sipas procedurave të parashikuara në kreun e pestë të kësaj rregulloreje.

## KREU VII RENDI I DITËS

52. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në bazë të projektakteve dhe të çështjeve të paraqitura nga anëtarët e Këshillit të Ministrave, përgatit rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave dhe ia paraqet për miratim Kryeministrit.

53. Si rregull, projektaktet përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit të Ministrave, nëse janë dërguar pranë Sekretarit të Përgjithshëm, të paktën 10 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Për arsye të motivuara dhe me miratimin paraprak të Kryeministrit, në rendin e ditës përfshihen projektakte të dërguara edhe pas afatit 10 ditor.

54. Rendi i ditës i mbledhjes, së bashku me materialet që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, i dërgohet nga Sekretari i Përgjithshëm çdo anëtar i Këshillit të Ministrave, jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.

55. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës shpërndahet jo më vonë se 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

56. Rendi i ditës përmban:

a) Tematikën që do të trajtohet.

b) Datën dhe orën e caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

c) Listën e titujve të projektakteve që do të shqyrtohen në mbledhje.

ç) Listën e çështjeve dhe të problemeve që do të diskutohen.

57. Rendi i ditës nënshkruhet nga sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

58. Kryeministri, në kushte dhe rrethana të paparashikuara, mund ta ndryshojë rendin e ditës.

59. Çështjet e rendit të ditës të mbetura pa u shqyrtuar në mbledhjen e radhës së Këshillit të Ministrave kalojnë automatikisht në mbledhjen pasardhëse, me përjashtim të rastit kur Kryeministri vendos ndryshe.

60. Si rregull, shqyrtimi i çështjeve të rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave fillon me shqyrtimin e çështjeve të mbetura nga mbledhjet e mëparshme, kur ka të tilla me përjashtim

të rasteve kur drejtuesi i mbledhjes vendos ndryshe.

61. Në njoftimin e rendit të ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, Sekretari i Përgjithshëm vendos shënimin për çështjet e mbetura për shqyrtim nga mbledhjet e mëparshme.

## KREU VIII

### DISKUTIMI I PROJEKTAKTEVE NË MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

62. Drejtuesi i mbledhjes paraqet thelbin e projektaktit, i kërkon ministrit propozues, nëse ka komente lidhur me propozimin e tij dhe më pas fton anëtarët e tjerë të Këshillit të Ministrave për të shprehur mendimin e tyre.

63. Pas përfundimit të diskutimit, drejtuesi i mbledhjes fton ministrat për votimin e projektaktit.

64. Në përfundim të shqyrtimit të projektaktit, Këshilli i Ministrave vendos:

- a) miratimin në gjendjen e paraqitur;
- b) miratimin me ndryshime;
- c) shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm;
- ç) mosmiratimin.

65. Mbledhja e Këshillit të Ministrave regjistrohet në procesverbal me stenografi dhe në rrugë elektronike.

## KREU IX

### BOTIMI DHE SHPËRNDARJA E AKTEVE

66. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave merr masa për:

- a) zbardhjen e të gjitha akteve të Këshillit të Ministrave;
- b) rregullimin e akteve të miratuara me ndryshime;
- c) nënshkrimin e akteve;
- ç) shpërndarjen e tyre në institucionet që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e aktit.

67. Sekretari i Përgjithshëm merr masat për botimin e të gjitha akteve normative të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare brenda afateve ligjore, si dhe në organe të tjera botuese, brenda një kohe sa më të shkurtër.

68. Shpërndarja zyrtare e akteve bëhet nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, jo më vonë se dy ditë pas nënshkrimit të tyre.